

Njoftim për media

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2020

Tiranë, më 14 Qershor 2018: Instituti i Statistikave me mbështetjen e UNICEF ka nisur konsultimet publike me grupet e interesuara, lidhur me pyetësin, që do të përdoret për regjistrimin e popullsisë dhe banesave. Ky konsultim ka për qëllim të përmirësojë dhe thjeshtësojë më tej pyetjet e bazuara mbi temat më thelbësore. Pyetësi i “Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020” është i ndarë në dy shtylla kryesore: Pyetje të detyrueshme, të cilat kanë një interes të përbashkët dhe janë të nevojshme për krahasime statistikore në nivel ndërkombëtar; dhe Pyetje jo të detyrueshme, të cilat janë opsionale dhe janë të nevojshme në varësi të situatës dhe kërkesave specifike të vendit.

Sipas Drejtoreshës së Përgjithshme të INSTAT, Znj. Delina Ibrahimaj, diskutimet me grupet e interesit janë tepër të rëndësishme për të eliminuar çdo keqkuptim të mundshëm. “Metodologjia që ne do të përdorim për regjistrimin e popullsisë vjen konform standardeve dhe rekomandimeve të Eurostat dhe OKB. Pyetësi duhet të jetë sa më transparent, në mënyrë që të arrijmë tek një format përfundimtar, i cili të plotësojë të gjitha kërkesat e grupeve të interesit”, tha Znj. Ibrahimaj.

Diskusimet e tryezës së përbashkët, u përqendruan tek minoritetet kombëtarë. Përfaqësues të minoritetit grek në Shqipëri, propozuan që për temën etno-kulturore, ku përfshihet etnia, feja dhe gjuha, të organizohet një tryezë e veçantë, në mënyrë që mos të ketë asnjë keqkuptim. Znj. Ibrahimaj siguroi që çdo aspekt dhe propozim do të merret në konsideratë për të përmirësuar pyetësin dhe pyetjet të jenë sa më të kuptueshme për të gjithë.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e FMN dhe UNDP në tryezë iu referuan Censit të vitit 2011, ku është regjistruar një numër i konsiderueshëm personash me aftësi të kufizuara, gjë që nuk reflektonte realitetin. Lidhur me këtë çështje, Znj. Ibrahimaj siguroi se janë marrë të gjitha masat edhe në bashkëpunim me institucionet e tjera partnere, që shifrat të reflektojnë realitetin.

Roli thelbësor i “Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020” është të mbledhë, përpunojë dhe të shpërndajë të dhënat e detajuara në lidhje me popullsinë, përbërjen e saj, karakteristikat, shpërhapjen hapësinore dhe organizimin e njësive ekonomike familjare. Roli kryesor i një censi është të prodhojë një numërim të saktë të popullsisë rezidente të një vendi. Ndërsa në terma të administrimit publik, ky numërim është i nevojshëm dhe përdoret në shumë vende për ndarjen e barabartë të fondeve publike.

INSTAT do të nisë zbatimin e projektit “Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare” (SALSTAT), i cili ka për qëllim të ndërtojë dhe mbajë një regjistër statistikor në nivel lokal (nga Bashkitë) dhe në nivel kombëtar (nga INSTAT). Përmes këtij projekti do të jetë e mundur të përmirësohet administrimi bashkiak duke siguruar efikasitet, efektivitet dhe pjesëmarrje të qytetarëve të tyre, bazuar në përmirësimin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave sipas standardeve të Eurostat-it. SALSAT është tërësisht i financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zvicerian për Zhvillim (SDC) dhe Zyra Statistikore Federale Zviceriane.